



FTESË PËR ANKAND PUBLIK (Dhënia e hapësirave/lokaleve me qira)

1. Dhënia e hapësirave/lokaleve afariste me qira

Në mbështetje të Vendimit nr.prot.02/195 datë 10.02.2026, në lidhje me shpalljen e Ankandit Publik, NPL "Stacioni i Autobusëve" SH.A. Prishtinë njofton të gjithë të interesuarit se ofron hapësira/lokale afariste për qiradhënie përmes procedurës së ankandit publik, sipas kushteve të mëposhtme:

Nr.	Përshkrimi i njësisë	Sipërfaqja në m ²	Identifikimi/Numri i lokalit/hapësirës	Çmimi fillestar PA TVSH (€)
1.	Lokal	15m ²	5	375€
2.	Lokal	8.55m ²	18	239.83€
3.	Lokal	19.02m ²	20	381.16€
	Terasë e Brendshme	17.20m ²		25.80€
4.	Lokal	304.73m ²	22	1,797.91€
5.	Lokal/Garazh	572.53m ²	25	2,822.57€
	Lokal	47.84m ²		406.64€
	Terasë e Jashtme/Oborr	400.45m ²		148.17€
	Terasë e Jashtme/Oborr	825.15m ²		305.31€
6.	Lokal	13.80m ²	29	345€
	Terasë e Jashtme	8.60m ²		27.09€
7.	Tokë	500m ²	33	375€
8.	Tokë	372m ²	34	279€
9.	Sportel	3.15m ²	2	300€
10.	Sportel	3.15m ²	3	300€
11.	Sportel	3.15m ²	4	300€

Shënim: Çmimi është pa TVSH.

2. Zhvillimi i veprimtarive në hapësirat/lokalet afariste

Sa i përket shfrytëzimit të hapësirës afariste gjatë procesit të ankandit publik, preferencat orientuese për dhënie me qira janë si vijon:

- **Për lokalet nr. 5, 18, 20, 22, 25 dhe 29** - preferohet shfrytëzimi i tyre si zyre administrative (hapësira afariste nr.25 – depo apo garazhd), ose për veprimtari të ngjashme, për kompani autotransportuese apo operatorë ekonomikë, veprimtaria e të cilëve nuk bie ndesh me aktivitetin e NPL "Stacioni i Autobusëve" SH.A. Prishtinë.
- **Për hapësirat afariste nr.33 dhe 34 të kategorizuar si "Tokë"** - preferohet shfrytëzimi i tyre për parking të operatorëve transportues, parking për taksit, rent-a-car, apo për veprimtari të tjera që nuk bien ndesh me aktivitetin e ndërmarrjes.
- **Për sportelet nr. 2, 3 dhe 4** - preferohet shfrytëzimi i tyre si zyra ose për veprimtari të ngjashme për kompanitë autotransportuese, veprimtaria e të cilave nuk bie ndesh me aktivitetin e NPL "Stacioni i Autobusëve" SH.A. Prishtinë.

Të drejtë pjesëmarrjeje në këtë procedurë kanë vetëm personat juridik, të cilët obligohen të paraqesin si dëshmi certifikatën e regjistrimit të biznesit.



3. Dokumentet e domosdoshme për pjesëmarrje në ankand:

Dokumentacioni i mëposhtëm është i detyrueshëm dhe mungesa e cilitdo prej tyre mund të rezultojë me refuzimin e aplikimit.

- **Kopja e Certifikatës së Regjistrimit të Biznesit me të gjitha dokumentet përcjellëse** dhe numri fiskal me të dhënat përkatëse;
- **Kopja e dokumentit të identifikimit të përfaqësuesit ligjor të biznesit;**
- **Oferta financiare** – çmimi për qiranë mujore (pa TVSH);
- **Të dhënat e arkës fiskale;**
- **Vërtetim nga ATK** që dëshmon se biznesi është aktiv;
- **Përshkrimi i veprimtarisë** që do të ushtrohet në hapësirën afariste, si dhe
- **Adresa e email-it** të personit/biznesit përmes së cilës do të zhvillohet komunikimi zyrtar ndërmjet palëve.

4. Kushtet dhe obligimet tjera

Pjesëmarrësit në këtë procedurë të ankandit publik janë të detyruar të dorëzojnë të gjitha dokumentet e domosdoshme të kërkuara sipas listës së përcaktuar më lart. Përveç dokumenteve të detyrueshme për dorëzim, pjesëmarrësit duhet të respektojnë edhe kushtet e mëposhtme, të cilat rregullojnë mënyrën e aplikimit, afatet dhe detyrimet pas shpalljes së rezultatit.

- Nga e drejta e pjesëmarrjes në ankand përjashtohen të gjithë debitorët që kanë obligime të pashlyera ndaj NPL "Stacioni i Autobusëve" SH.A. Prishtinë.
- Ndërmarrja nuk do të japë në shfrytëzim hapësirat afariste bizneseve të paregjistruara, si dhe atyre që ushtrojnë veprimtari në kundërshtim me reputacionin dhe interesat e ndërmarrjes.
- Kriteri themelor për dhënien e kontratës është oferta me çmimin më të lartë.
- Të gjitha palët e interesuara kanë mundësi ta inspektojnë hapësirat/lokalet çdo ditë pune, nga ora 08:00 deri në 16:00.
- Afati për dorëzimin e ofertave është i përcaktuar deri më **16.03.2026**, ora **14:00**, ndërsa hapja e tyre do të bëhet po atë ditë, në ora 14:30, në hapësirat e ndërmarrjes.
- Ofertat duhet të dorëzohen të mbyllura në zarfe dhe të protokolohen në zyrën e arkivit të ndërmarrjes.
- Në hapjen e ofertave kanë të drejtë të marrin pjesë të gjithë ofertuesit.
- Subjekti i shpallur fitues është i obliguar që brenda pesë (5) ditëve kalendarike nga njoftimi se i njejtë është shpallur fitues, të e nëshkruaj kontratën për qiradhënie.

5. Të tjera

Dhënia me qira e hapësirave afariste bëhet për një periudhë një (1) vjeçare, me mundësi vazhdimi, në përputhje me rregulloren e brendshme që rregullon lëshimin e hapësirave afariste dhe vendosjen e objekteve të përkohshme.

Për informata më të hollësishme, palët e interesuara mund të kontaktojnë në adresën elektronike contact@sap-rks.com ose në numrin e telefonit 038 551 333.

